

TE MARIT E GJAKUT

Nga mungesa e një qeverie e cila të ish e zonja që të regullonte punët e Mirditës me drejtësi, nga konsepsioni primitif se drejtësia munt të zbatohet prej personit të dëmtuar, nga natyra kryenaltë e Mirditasit dhe të Malësorit përgjithësisht që të mos durojë nonjë insulltë a nonjë dëm që i është bërë dhe me këtë mënyrë të zbatojë parimin “dhëmp për dhëmp”, dhe nga interesi i kryetarëve të cilët prej pajtimit e gjakeve kishin një të ardhur të mirë, Gjak-marja, ky MALLKIM i Maleve t’ona, ka eksistuar në Mirditë deri në kohërat e fundit. Sot “gjaku” është në dorën e Qeverisë dhe me mbledhjen e pushkëve vrasjet kanë arrirë në një shkallë shumë të ulët, kështu që gjithsisht munt t’u dhëtojë nër këto shkrejtëira me një siguri të madhe. “Mâ parë, “më thoshin burrat e dheut kur binte fjala, “s’ guzojshin me dal ke praku i derës se të vritshin! Tash kena çetsi dhe robi mun me dal në bjeshk me gjân, ase me punue në tokën e vet.” Ç’ ndryshim!

Kanuni i Lekës nër nyjat e saj caktonte dënimin që i jepeshe personit për një padrejtësi që bënte, dhe dami, i cili caktonte prej pleqve kish çmim po jo p shkë. Vrasja munt të ngjiste